



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURENCES

**Njoftim për shtyp
(04 Mars 2016)**

Mbi Ditën Kombëtare të Konkurrencës dhe zhvillimin e seminarit mbi procedurat e kontrollit të përqëndrimeve në rastin e Shqipërisë

Me rastin e Ditës Kombëtare të Konkurrencës Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me “Kalo Associates” zhvilloi sot një workshop me shoqatat e biznesit dhe firmat ligjore lidhur me procedurat e kontrollit të përqëndrimeve në rastin e Shqipërisë.

Në fjalën e saj kryetarja e Autoritetit Znj. Lindita Milo(Lati) u shpreh se Autoriteti i Konkurrencës në përvjetorin e 12-të të krijimit vjen në një bashkëbisedim me partnerët e biznesit, studiot ligjore dhe aktorë të tjerë të tregut për të adresuar eksperiencën pozitive dhe jopozitive gjatë zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” në plotësim të misionit për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Duke analizuar madhësinë dhe strukturën e tregut shqiptar, Znj. Milo u shpreh se kryesisht tregjet e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë mbartin në vetvete një risk të lartë të sjelljeve bashkërenduese midis kompanive apo marrëveshjeve të fshehta për fiksimin e çmimit apo ndarjen e tregut si dhe potencialisht abuzimin me pozitën dominuese të ndërmarrjeve që kanë fuqi tregu.

“Lidhur me kontrollin e përqëndrimeve synimi i Autoritetit të Konkurrencës është të ushtroj kontrollin dhe të parandalojë rritjen e përqendrimit në treg kur kjo realizohet nëpërmjet transaksioneve të shit/blerjes së aksioneve pjesërisht apo plotësisht të një kompanie nga një tjetër”, u shpreh Znj. Lati .

Më pas nga ana e pjesëmarrësve u diskutua mbi rritjen e efektivitetit të rolit të Autoritetit të Konkurrencës në rastet e përqëndrimeve, ndryshimit të kontrollit, bashkimit të ndërmarrjeve apo krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta(joint venture) duke analizuar legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe eksperiencën e Shqipërisë në këtë proces.

Pjesëmarrësit në përgjithësi u shprehën se ligji shqiptar është i përafëruar në një shkallë të lartë me *acqui-communitaire* dhe u sollën praktikat më të mira ndërkombëtare në funksion të uljes së kostove të biznesit në procedurat e kontrollit të përqëndrimeve.